



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
SHËRBIMI I PROVËS
DREJTORIA E PËRGJITHSHME

R A P O R T
PËR MUAJIN TETOR 2011

PËRMBAJTJA

Lënda	Faqe
I. Statistika	
-Numri i të dënuarve me dënime alternative të dhëna nga gjykatat për muajin Tetor 2011 .	(1)
- Numri total i të dënuarve me dënime alternative të dhëna nga gjykatat për secilin lloj dënimi alternativ.	(2-3)
- Numri total i të dënuarve me dënime alternative që ndodhen aktualisht nën mbikëqyrjen e Shërbimit të Provës (datë 31.10.2011).	(4)
- Numri mesatar i të dënuarve me dënime alternative që mbikëqyren nga një punonjës i Shërbimit të Provës në nivel vendi dhe zyre vendore	(6)
-Raportet e Vlerësimit me kërkesë të gjykatës dhe prokurorisë.	(7)
II. Bashkëpunimi me partnerët	
-me OJF-të dhe partnerët.	(8)
-me organet e pushtetit qëndror dhe pushtetin vendor	(9)
III. Problematika e punës.	
- Zyrat e reja Vendore dhe ngarkesa.	(10)

I nderuar Zoti Ministër,

Mbështetur në nenin 9, gërma gj), të VKM nr. 302, datë 25.03.2009 "Për miratimin e Rregullores "Për organizimin e funksionimin e Shërbimit të Provës dhe për përcaktimin e standardeve dhe procedurave për mbikëqyrjen e ekzekutimit të dënimeve alternative", po Ju paraqesim raportin e veprimtarisë së Shërbimit të Provës për muajin Tetor 2011.

I. Statistika

Për periudhën 01-31 Tetor 2011, volumi i punës së kryer nga Shërbimi i Provës ka qenë i madh, duke marrë parasysh faktin që numri i specialistëve të Zyrave Vendore të Shërbimit të Provës është i njëjti, ndërsa numri i të dënuarve me dënime alternative që këta specialistë mbikëqyrin, si dhe kërkesat nga gjykatat dhe prokuroritë për raporte vlerësimi janë në rritje të vazhdueshme. Disa nga statistikat dhe paraqitjet që pasqyrojnë punën që ka kryer e po kryen institucioni do të jepen me anë të të dhënave si më poshtë:

Për periudhën 01- 31 Tetor 2011, statistikat rezultojnë si më poshtë:

1. Numri i të dënuarve me dënime alternative të dhëna nga gjykatat për muajin Tetor 2011 .

Në muajin Tetor, nga data 01-31.10.2011, kanë ardhur pranë Zyrave Vendore 146 Urdhëra Ekzekutimi nga Prokuroria, që do të thotë se do të mbikëqyren nga Shërbimi i Provës edhe 146 të dënuar më shumë. Gjatë këtij muaji kanë përfunduar dënimin alternativ 74 të dënuar. Këto të dhëna jepen më poshtë sipas Tabelës 1.

Tabela 1. Të dënuarit shtesë në mbikëqyrje nga Shërbimi i Provës për muajin Tetor 2011 (01-31.10.2011).

Nr	LLOJI I DËNIMEVE ALTERNATIVE	SHTOHEN	PËRFUNDUAN	TOTALI
1	Pezullimi ... neni 59 i KP	115	56	59
2	Qëndrimi në shtëpi neni 59/a i KP	5	2	3
3	Lirimi me kusht neni 64 i KP	16	8	8
4	Punë në interes publik neni 63 i KP	10	11	-1
5	Gjysmëliria neni 58 i KP	0	0	0
TOTALI		146	77	69

Duke ju referuar statistikave, gjatë muajit Tetor 2011 janë shtuar për mbikëqyrje 146 të dënuar dhe kanë përfunduar periudhën e mbikëqyrjes 77 të dënuar. Nga kjo del se rritja e ngarkesës për periudhën 01-30 Tetor 2011 është 69 të dënuar vetëm për mbikëqyrje.

Për periudhën 01 Qershor 2009 - 31 Tetor 2011, statistikat rezultojnë si më poshtë:

2. Numri total i të dënuarve me dënime alternative të dhëna nga gjykatat për secilin lloj dënimi alternativ.

Numri total i të dënuarve me dënime alternative që janë mbikëqyrur nga Shërbimi i Provës në të gjithë vendin, për periudhën, nga data **01.06.2009 deri më datë 31.10.2011**, është **4258** të dënuar. Nga këta, **67** të dënuar janë shtetas të huaj dhe me vendbanim jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për të cilët Shërbimi i Provës zbaton rregullat e "Konventës Europiane për mbikëqyrjen e personave të dënuar ose të liruar me kusht", duke bashkëpunuar me Ministrinë e Drejtësisë.

Nga 01.06.2009 - 31.10.2011, kanë përfunduar periudhën e provës nën mbikëqyrjen e Shërbimit të Provës **748** të dënuar, pra ka përfunduar me sukses procesi i mbikëqyrjes për ta.

Statistikat për periudhën **01.06.2009 - 31.10.2011**, për secilin lloj dënimi alternativ, për të dënuarit e mbikëqyrur nga Shërbimi i Provës, janë si më poshtë:

- **3333** persona janë dënuar nga gjykata duke u aplikuar neni 59 i KP "pezullim i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë", shifër kjo e barabartë me **78.27 %** të të gjithë të dënuarve me dënime alternative.
- **97** persona janë dënuar nga gjykata duke u aplikuar neni 59/a i KP "qëndrim në shtëpi", shifër kjo e barabartë me **2.28 %** të të gjithë të dënuarve me dënime alternative.
- **441** persona janë dënuar nga gjykata duke u aplikuar neni 64 i KP "Lirim me kusht", shifër kjo e barabartë me **10.36 %** të të gjithë të dënuarve me dënime alternative.
- **386** persona janë dënuar nga gjykata duke u aplikuar neni 63 i KP "Pezullim i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe detyrimi për kryerjen e një pune në interes publik", shifër kjo e barabartë me **9.07 %** të të gjithë të dënuarve me dënime alternative.

- 1 person është dënuar nga gjykata duke aplikuar nenin 58 të KP "gjysëmlliria", shifër kjo e barabartë me 0.02 % të të gjithë të dënuarve me dënime alternative.

Këto të dhëna pasqyrohen më poshtë, në Tabelën 2.

Tabela 2: Numri i të dënuarëve sipas llojeve të dënimeve alternative të dhëna nga Gjykata për periudhën 01.06.2009 - 31.10.2011.

Nr	LLOJI I DËNIMEVE ALTERNATIVE	Nr. TOTAL	TOTALI në %
1	Pezullimi ... neni 59 i KP	3333	78.27%
2	Qëndrimi në shtëpi neni 59/a i KP	97	2.28%
3	Lirimi me kusht neni 64 i KP	441	10.36%
4	Punë në interes publik neni 63 i KP	386	9.07%
5	Gjysmëliria neni 58 i KP	1	0.02%
TOTALI		4258	100%

Për periudhën 01.06.2009 - 31.10.2011 numri i të dënuarve me "punë në interes publik" është **386**, ndërsa pas përfundimit të këtij dënimi për 295 të dënuar, Shërbimi i Provës ka nën mbikëqyrje **91** të dënuar.

3. Numri total i të dënuarve me dënime alternative që ndodhen aktualisht nën mbikëqyrjen e Shërbimit të Provës (datë 31.10.2011).

Numri total i të dënuarve që ndodhen aktualisht nën mbikëqyrjen e Shërbimit të Provës (duke zbritur numrin e atyre që kanë përfunduar dënimin alternativ) është **3510 të dënuar**.

I ndarë sipas llojeve të dënimeve alternative, ky numër jepet në Tabelën 3.

Tabela 3. Të dënuarët që janë aktualisht nën mbikëqyrjen e Shërbimit të Provës (datë 31.10.2011).

Nr	LLOJI I DËNIMEVE ALTERNATIVE	Nr. TOTAL	TOTALI në %
1	Pezullimi ... neni 59 i KP	2969	84.59%
2	Qëndrimi në shtëpi neni 59/a i KP	48	1.36%
3	Lirimi me kusht neni 64 i KP	402	11.45%
4	Punë në interes publik neni 63 i KP	91	2.6%
5	Gjysmëliria neni 58 i KP	0	0 %
TOTALI		3510	100%

I ndarë sipas Zyrave Vendore (duke llogaritur dhe të dënuarit që kanë përfunduar dënimin alternativ):

- Në territorin që shtrin kompetencat Zyra Vendore Tiranë mbikëqyren në komunitet nga Shërbimi i Provës **1359** të dënuar me dënime alternative.
- Në territorin që shtrin kompetencat Zyra Vendore Durrës mbikëqyren në komunitet nga Shërbimi i Provës **384** të dënuar me dënime alternative.
- Në territorin që shtrin kompetencat Zyra Vendore Fier mbikëqyren në komunitet nga Shërbimi i Provës **507** të dënuar me dënime alternative.
- Në territorin që shtrin kompetencat Zyra Vendore Shkodër mbikëqyren në komunitet nga Shërbimi i Provës **585** të dënuar me dënime alternative.
- Në territorin që shtrin kompetencat Zyra Vendore Lezhë mbikëqyren në komunitet nga Shërbimi i Provës **226** të dënuar me dënime alternative.
- Në territorin që shtrin kompetencat Zyra Vendore Elbasan mbikëqyren në komunitet nga Shërbimi i Provës **186** të dënuar me dënime alternative.

- Në territorin që shtrin kompetencat Zyra Vendore Korçë mbikëqyren në komunitet nga Shërbimi i Provës **188** të dënuar me dënime alternative.
- Në territorin që shtrin kompetencat Zyra Vendore Gjirokastrë mbikëqyren në komunitet nga Shërbimi i Provës **75** të dënuar me dënime alternative.

4. Numri mesatar i të dënuarve me dënime alternative që mbikëqyren nga një punonjës i Shërbimit të Provës në nivel vendi dhe zyre vendore.

Sa më sipër duke ju referuar numrit total të të dënuarve me dënime alternative që mbikëqyren nga Shërbimi i Provës prej **3510** të dënuarish, numri mesatar i të dënuarve që mbikëqyren nga një punonjës në nivel vendi aktualisht është **117**. E shprehur kjo për çdo zyrë vendore është si më poshtë:

- Zyra Vendore Tiranë ka nën mbikëqyrje **136** të dënuar për çdo punonjës.
- Zyra Vendore Durrës ka nën mbikëqyrje **128** të dënuar për çdo punonjës.
- Zyra Vendore Fier ka nën mbikëqyrje **84** të dënuar për çdo punonjës.
- Zyra Vendore Shkodër ka nën mbikëqyrje **195** të dënuar për çdo punonjës.
- Zyra Vendore Lezhë ka nën mbikëqyrje **75** të dënuar për çdo punonjës.
- Zyra Vendore Elbasan ka nën mbikëqyrje **93** të dënuar për çdo punonjës.
- Zyra Vendore Korçë ka nën mbikëqyrje **94** të dënuar për çdo punonjës.
- Zyra Vendore Gjirokastrë ka nën mbikëqyrje **75** të dënuar për çdo punonjës.

4. Raportet e Vlerësimit me kërkesë të gjykatës dhe prokurorisë.

Konkretisht për periudhën **01-31 Tetor 2011:**

- ❖ Janë kërkuar nga gjykatat **72** raporte vlerësimi për persona të pandehur dhe të dënuar,
- ❖ Janë kërkuar nga prokuroritë **22** raporte vlerësimi për persona nën hetim dhe të pandehur,
- ❖ Kanë ardhur **146** urdhëra ekzekutimi nga prokuroritë e rretheve gjyqësore, nga të cilët **52** urdhëra ekzekutimi janë për dënime alternative të dhëna për të mitur, për të cilët gjykata ka dhënë dënime alternative dhe kanë filluar procedurat ligjore të përcaktuara për procesin e mbikëqyrjes për ta.
- ❖ Ka përfunduar mbikëqyrja për **77** të dënuar me dënime alternative.

Ndërsa në total volumi i punës së Shërbimit të Provës për periudhën **01.06.2009 - 31.10.2011** jepet si më poshtë:

- ❖ janë kërkuar nga gjykata **1632** raporte vlerësimi për persona të pandehur dhe të dënuar,
- ❖ janë kërkuar nga prokuroritë **803** raporte vlerësimi për persona nën hetim dhe të pandehur,
- ❖ Kanë ardhur **4258** urdhëra ekzekutimi nga prokuroritë e rretheve gjyqësore, nga të cilët **691** urdhëra ekzekutimi janë për dënime alternative të dhëna për të mitur dhe **67** urdhëra ekzekutimi janë për shtetas të huaj dhe me vendbanim jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për të cilët gjykata ka dhënë dënime alternative dhe kanë filluar procedurat ligjore të përcaktuara për procesin e mbikëqyrjes për ta.
- ❖ Ka përfunduar procesi i mbikëqyrjes për **748** të dënuar.

II. Bashkëpunimi me partnerët.

- *me OJF-të dhe partnerët.*

- Gjatë muajit Tetor 2011 ka vazhduar normalisht bashkëpunimi i Zyrave Vendore me OJF-të, sipas Marrëveshjeve që kemi lidhur me to, për trajtimin e rasteve të mbikëqyrjes për të dënuarit me dënime alternative.
- Gjatë muajit Tetor 2011, Shërbimi i Provës ka vazhduar bashkëpunimin me Qendrën e Shërbimeve Ligjore dhe Praktikave të Integruara (QSHPLI), nëpërmjet Zyrave Vendore dhe degëve të kësaj qendre, me qëllim koordinimin e shërbimeve në lidhje me zbatimin e dënimeve alternative për të miturit, të cilët përfitojnë nga ky program.

Përsa i përket punës me të dënuarit e mitur me synim përmirësimin e praktikave të institucionit të Shërbimit të Provës në lidhje me këta të dënuar që kryejnë kryesisht dënimin alternativ “punë me interes publik” (neni 63 i K. Penal), është zhvilluar në datën 13.10.2011, takimi me Z. Robert Badinter (ish ministër i Drejtësisë në Francë) dhe delegacionit të tij shoqëruar, mundësuar në sajë të mbështetjes së UNICEF. Pjesëmarrës të tjerë të këtij takimi ishin Z. Abdyl Spahiu, Drejtor i zyrës vendore Tiranë të Shërbimit të Provës, Znj. Migena Koçollari, specialiste e Zyrës Vendore të Shërbimit të Provës Tiranë, përfaqësues të Qendrës së Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara (QSHPLI) Znj. Holta Kotherja, Drejtore ekzekutive e Qendrës së Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara (QSHPLI), Znj. Naureda Hasani, koordinatore e projektit “Klinika Ligjore për të miturit” (QSHPLI). Gjithashtu në këtë takim ishin pjesëmarrës përfaqësues të qendrës pritëse, Drejtoria e Gjelbërimit Tiranë dhe 4 të mitur të dënuar me punë në interes publik, 2 prej të cilëve duke kryer këtë dënim, ndërsa të tjerët në fazën e fillimit të procedurave të përcaktimit të punës që do të kryejnë.

Në këtë takim, Shërbimi i Provës në bashkëpunim me QSHPLI priti këtë grup në ambientet e Drejtorisë së Gjelbërimit Tiranë, si përfaqësuese e institucioneve të pushtetit lokal që ofrojnë ndihmën në zbatimin e dënimeve alternative në Shqipëri. Ky takim ishte pjesë e një vizite të zhvilluar nga Z. Badinter për të parë të gjitha hapat nëpër të cilat kalon një i mitur, që nga momenti i arrestimit e deri në përfundimin e dënimin, duke përfshirë këtu institucionet përkatëse të përgjegjshme për secilën

fazë. Gjithashtu, qëllimi i vizitës së tij ishte mbështetja e reformës së drejtësisë për të miturit, duke u përqëndruar në përmirësimin e kushteve dhe trajtimin e të miturve në sistemin gjyqësor. Z. Badinter vizitoi Rajonet/Komisariatet e Policisë dhe institucionet e paraburgimit, Shërbimit të Provës, si dhe kreu takim me Kryeministrin, Ministrin e Drejtësisë dhe zyrtarë të lartë qeveritarë. Konkretisht, delegacioni shfaqti interes për ecurinë e dënimeve alternative në Shqipëri. Shërbimi i Provës dhe QSHPLI iu përgjigjën të gjitha pyetjeve që ata kishin në lidhje me trajtimin e të dënuarve gjatë zbatimit të dënimeve alternative dhe situatën e dënimeve alternative në Shqipëri. Z. Badinter intervistoi secilin prej këtyre të miturve kryesisht për çështje që lidhen me dënimin e tyre, perceptimin e të miturve për këto dënime si dhe për problematika të ndryshme të ndeshura gjatë zbatimit të dënimit. Në këtë takim, i cili zgjati përreth 2 orë, ndër të tjerash u dha informacion nga Shërbimi i Provës lidhur me qëllimin e këtij insitucioni për mbështetjen që u jep kryesisht të miturve në zbatimin e dënimit alternativ, trajnimet e vazhdueshme për kualifikim e punonjësve të Shërbimit të Provës edhe në punën me të miturit mbështetur nga BE. Gjithashtu, u diskutua rreth marrëveshjeve të bashkëpunimit midis Shërbimit të Provës dhe Organizatave Jofitimprurëse apo institucioneve të pushtetit lokal në mbështetje të zbatimit të dënimeve alternative.

- Më datën 21 Tetor 2011, në qytetin e Korçës, në bashkëpunim me Fondacionin "Zgjidhja e Konflikteve dhe Pajtimi i Mosmarreveshjeve" u realizua një tryezë e rrumbullakët me temë "Drejtësia Restauruese dhe Ndërmjetësimi - forma alternative për zgjidhjen e konflikteve penale". Në këtë takim morën pjesë, Përgjegjësi i Sektorit Juridik dhe Marrëdhënieve me Publikun i Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës, Z. Saimir Shyti, Drejtori Ekzekutiv i FZK, Z. Rasim Gjoka, punonjësit e ZVSHP Korçë, përfaqësues nga OJF-të tjera me të cilat Shërbimi i Provës ka Memorandume Bashkëpunimi, si dhe rreth 25 të dënuar të grupmoshës 14-21 vjeç, të cilët mbikqyren nga kjo zyrë vendore.

Në këtë takim nga përfaqësuesi i Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës, u referua "Mbi bashkëpunimin midis Shërbimit të Provës dhe Shërbimit të Ndërmjetësimit në bazë të Rregullores, për zbatimin e drejtësisë restauruese dhe ofrimin e shërbimit të ndërmjetësimit veçanërisht për të miturit". Gjithashtu nga Drejtori i FZK, u trajtua tema

“Mbi shërbimin e ndërmjetësimit dhe drejtësinë restauruese, si dhe mundësitë e zbatimit praktik të ndërmjetësimit dhe vlerat pozitive që mbart ai, si dhe rastet kur mund të ofrohet shërbimi i ndërmjetësimit parashikuar në ligjin e ri dt. 24.02.2011 “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve”.

Në fund të takimit pati pyetje dhe diskutime me pjesëmarrësit për mundësitë që ekzistojnë për ofrimin e shërbimit të ndërmjetësimit dhe drejtësisë restauruese.

Ky aktivitet u zhvillua me mbështetjen e UNICEF, në kuadër të projektit: “Forcimi i bashkëpunimit institucional për zbatimin e drejtësisë restauruese dhe ndërmjetësimit për të miturit”.

Aktivitet tjetër në këtë kuadër, është planifikuar të zhvillohet në bashkëpunim me Zyrën Vendore Gjyrokastër, në datën 1 nëntor 2011.

- Në muajin tetor ka vazhduar implementimi i Projektit të Binjakëzimit me Mbretërinë e Bashkuar, sipas planit të aktiviteteve të përcaktuar për këtë projekt.

Në datat 10 – 14 Tetor 2011, në ambientet pranë DPSHP është zhvilluar një trajnim me temë “Programe individuale dhe ato në grup”, ku morën pjesë 5 punonjës të zyrave vendore dhe 1 punonjës i Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës. Trajnimi u krye nga dy ekspertë britanikë me eksperiencë në këtë fushë, Znj. Meg Blumson dhe Z. Danny Clark.

Në datat 17-21 Tetor 2011, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës, u zhvillua një trajnim tjetër me temë “Trajtimi i të dënuarve përdorues substancash”. Në këtë trajnim morrën pjesë 7 punonjës, 5 nga Zyrat Vendore dhe 2 nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës. Ky trajnim u zhvillua nga dy eksperte britanike me përvojë në këtë fushë, Znj. Meg Blumson dhe Znj. Sue Pearce.

Gjithashtu pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës, në datat 24-26 Tetor 2011 u zhvillua një trajnim me temë “Mbi hyrjen në sistemin e vlerësimit OAS-ys”. Në këtë trajnim morrën pjesë 7 punonjës nga Zyrat Vendore të Shërbimit të Provës. Ky trajnim u zhvillua nga dy ekspertë britanikë me përvojë në këtë fushë, Z. David Atkinson dhe Z. Joe Woods.

- Për sa i përket bashkëpunimit me Policinë e Shtetit theksojmë se ky bashkëpunim ndërmjet Zyrave Vendore me Komisaritet dhe Drejtoritë e

Policisë në qarqe, ka qenë mjaft i mirë dhe frytdhënës, sidomos për gjetjen dhe njoftimin e personave për të cilët nuk ka pasur adresa të sakta, në urdhërat e ekzekutimit të prokurorive.

- Një bashkëpunim të mirë kemi pasur edhe me gjykatat dhe prokuroritë me gjithë problemet e hasura gjatë punës sonë me këto institucione.
- Po ashtu me pushtetin vendor, ka vazhduar bashkëpunimi i mirë i Zyrave Vendore me ato komuna dhe bashki me të cilat janë lidhur Memorandumet e Bashkëpunimit.

Për sa i përket bashkëpunimit me pushtetin vendor, përveç 84 memorandumeve të bashkëpunimit midis Shërbimit të Provës dhe organeve të qeverisjes vendore, për të cilat ju kemi bërë me dije në raportet tona të mëparëshme, për muajin Tetor 2011, kemi nënshkruar edhe 3 memorandume bashkëpunimi me njësitë e qeverisjes vendore të qarkut Gjirokastrë dhe konkretisht me: Bashkinë Durrës, Komunën Orosh/Mirditë dhe Komunën Zejmen/Lezhë.

Qëllimi i këtyre marrëveshjeve më njësitë e qeverisjes vendore, është sigurimi prej tyre i vendeve të punës për personat me banim në komunitetin e tyre, për të cilët gjykata ka dhënë si masë alternative punën me interes publik apo edhe për rastet e dënuarve me dënime të tjera alternative për të cilat pushteti vendor është drejtpërdrejt i interesuar me qëllim garantimin e sigurisë publike të komunitetit, riintegrimin në shoqëri të personit të dënuar që është anëtar i atij komuniteti, si dhe ndihmën e të dënuarit për t'u riintegruar në komunitet.

Pra, në total janë nënshkruar 87 memorandume bashkëpunimi midis Shërbimit të Provës dhe organeve të qeverisjes vendore dhe konkretisht me 6 Këshilla Qarqesh, 29 Bashki (nga të cilat 5 Njësi Bashkiake në Tiranë) dhe 52 Komuna. Ndërkohë që vazhdon puna dhe korrespondenca për nënshkrimin e memorandumeve të bashkëpunimit edhe me bashkitë dhe komunat e tjera.

III.-Problematika e punës.

- Zyrat e reja Vendore dhe ngarkesa.

Sikurse Ju kemi bërë me dije dhe në kërkesë-propozimin tonë të fundit me nr. 1655/1, datë 04.08.2011, për ndryshimin e strukturës dhe organikës së Shërbimit të Provës, (në ripërsëritje të shkresës me nr. 88 Prot., datë 13.01.2011), si dhe në Raportin Vjetor mbi aktivitetin e Shërbimit të Provës, për periudhën 1 janar - 31 dhjetor 2010, dërguar me tonën nr. 378, datë 28.02.2011, problemi kryesor del hapja e zyrave të reja vendore me vendodhje në të gjitha rrethet gjyqësore ku nuk janë ngritur ende, si dhe ndryshimi i strukturës dhe shtimi i organikës së Shërbimit të Provës, me qëllim administrimin dhe ushtrimin e funksioneve në mënyrën e kërkuar nga ligji dhe arritjen e standardeve të parashikuara në Strategjinë Sektoriale të Drejtësisë dhe SKZHI-së, për Shërbimin e Provës, ku një nga indikatorët është dhe raporti i numrit të dënuarve që mbikëqyren mesatarisht për një specialist të Shërbimit të Provës, përkatësisht 35-40 të dënuar /specialist.

Jemi në pritje të hapjes së 4 Zyrave të reja Vendore me vendndodhje në Kukës, Mat, Berat dhe Vlorë, të cilat sipas parashikimeve në Plan-veprimet për Shërbimin e Provës dhe raportimeve në dokumentat strategjike për institucionet e BE-së, këto zyra duhej të hapeshin brenda muajit Tetor.

Mjafton të përmendim se deri tani janë në mbikëqyrje nga institucioni ynë 3510 të dënuar, ose mesatarisht 117 të dënuar për çdo specialist, numër i cili vazhdon të rritet, dhe që është shumë më i lartë se standartet e vendeve të BE, pa shtuar këtu faktin se punonjësit tanë deri më tani kanë hartuar mesatarisht edhe 81 raporte vlerësimi për specialist, sipas kërkesave të gjykatave dhe prokurorive, gjë që e bën të papërbalueshme ngarkesën e punës.

Duke shpresuar se kemi dhënë një analizë që pasqyron me objektivitet punën e kryer, si dhe një paraqitje të problematikës themelore nga Shërbimi i Provës, Ju sigurojmë se zbatimi i të gjithë detyrave funksionale, rritja e nivelit dhe e profesionalizmit do të jenë prioritetet e punës sonë edhe në të ardhmen.

Me respekt,

DREJTORI I PËRGJITHSHËM

ARBEN SEFGJINI

